

- më poshtë e/i quajtur "Përfituesi i Grantit" –

dhe

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit

Zyra e GIZ-së, Shqipëri

Rr. Skënderbej, Nr.21/1

Tiranë

Shqipëri

- më poshtë e quajtur "GIZ" -

Me anë të këtij dokumenti lidhin Marrëveshjen e mëposhtme për projektin

SARED – Mbështetje për Bujqësinë dhe Zhvillimin Ekonomik Rural në Zonat e Pazhvilluara të Shqipërisë (2014-2018) (Mbështetje e përbashkët gjermano-daneze)

Vendi: **Shqipëria**

Për korrespondencën dhe faturat (Ju lutem vendosini në të gjithë korrespondencën dhe faturat)

Nr. i kontratës.:

Nr. i projektit:

Nr. ID të Aplikimit:

Deutsche Gesellschaft für
Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Sitz der Gesellschaft Bonn und Eschborn

Friedrich-Ebert-Allee 40
53113 Bonn, Deutschland
T +49 228 44 60-0
F +49 228 44 60-17 66

Dag-Hammarskjöld-Weg 1-5
65760 Eschborn, Deutschland
T +49 61 96 79-0
F +49 61 96 79-11 15

E info@giz.de
I www.giz.de

Amtsgericht Bonn
Eintragungs-Nr. HRB 18384
Amtsgericht Frankfurt am Main
Eintragungs-Nr. HRB 12394
USt-IdNr. DE 113891176
Steuernummer 040 250 56973

Vorsitzender des Aufsichtsrats
Staatssekretär Dr. Friedrich Kitschelt

Vorstand
Tanja Gönner (Vorstandssprecherin)
Dr. Christoph Beier (Stellv. Vorstandssprecher)
Dr. Hans-Joachim Preuß
Cornelia Richter

Commerzbank AG Frankfurt am Main
BLZ 500 400 00
Konto 58 89 555 00
BIC (SWIFT): COBADEFFXXX
IBAN: DE45 5004 0000 0588 9555 00

Neni 1

Shuma dhe Qëllimi i Grantit

- 1.1 Në emër të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Mbretërisë së Danimarkës, GIZ-ja do t'i bëjë të disponueshëm Përfituesit një grant prej
- deri në (Lekë / shuma)** (me fjalë: _____),
- që është ekuivalente me ____% të shpenzimeve totale të pranueshme të perlllogaritura të Investimit të specifikuar në paragrafin 1.6. Shuma finale e kontributit të GIZ-së do të përcaktohet në përputhje me Nenin 8 të Aneksit 3 të kësaj marrëveshjeje.
- 1.2 Përfituesi duhet ta përdorë grantin ekskluzivisht për shpenzimet e përcaktuara në Aneksin 1 të kësaj marrëveshjeje brenda Përshkrimit të Investimit përshkruar në Nenin 2 që i atribuohet granti të GIZ-së në përputhje me Tabelën e Shpenzimeve të Perlllogaritura, që përcakton detajet e shpenzimeve të Investimit. Tabela e Shpenzimeve të Perlllogaritura është bashkëngjitur këtij dokumenti (Aneksi 1) dhe është pjesë përbërëse e Marrëveshjes.
- 1.3 Granti bëhet i disponueshëm për periudhën nga _____ deri _____. Vetëm shpenzimet e kryera gjatë kësaj periudhe dhe që lidhen me Investimin e kryer gjatë kësaj periudhe mund të financohen nga granti. Për raste të tjera kërkohet miratimi me shkrim nga GIZ-ja. GIZ-ja do të ketë të drejtën e refuzimit të disbursimeve pas _____.
- 1.4 Përfituesi duhet ta përdorë grantin e GIZ-së vetëm për shpenzime të pranueshme në përputhje me parimet e shëndosha të biznesit dhe në përputhje me Nenet dhe Aneksat e kësaj marrëveshjeje.
- 1.5 Granti i GIZ-së mund të përdoret vetëm për shpenzime që nuk financohen nga subvencione të tjera.
- 1.6 Shpenzimet e pranueshme totale të investimit perlllogariten të jenë në _____ Lekë (me fjalë: _____), siç përcaktohet në Aneksin 1 të kësaj marrëveshjeje.

Burimet e pritshme të financimit të shpenzimeve totale të perlllogaritura janë si më poshtë:

Kontributi i GIZ-së

Kontributi i Përfituesit të Grantit

Kontributi respektiv i të dy palëve për shpenzimet totale të pranueshme të perlllogaritura të Investimit tregohet në Tabelën e Shpenzimeve të Perlllogaritura (Aneksi 1).

Nëse shpenzimet reale për një zë buxheti që do të financohen nga të dy palët janë më pak se shpenzimet e perlllogaritura, granti i GIZ-së për këtë zë buxheti duhet të reduktohet në të njëjtin proporcion sa janë reduktuar shpenzimet reale në lidhje me shpenzimet e planifikuara.

Neni 2

Projekti

2.1 Synimi primar i Projektit i promovuar nga granti është:

2.2 Për arritjen e këtij synimi janë planifikuar masat e mëposhtme:

Zbatimi i Investimit

Përshkrimi i Investimit është bashkëngjitur këtij dokumenti (Aneksi 2) dhe është pjesë përbërëse e Marrëveshjes.

2.3 Përfituesi i Grantit duhet ta zbatojë Investimin nën përgjegjësinë e tij dhe në përputhje me Përshkrimin e Investimit (Aneksi 2), me synimin për arritjen e objektivave të përcaktuara aty.

Neni 3

3.1 Dorëzimi i Kërkesës për Pagesë duhet të bëhet në përputhje me Nenin 8 të Kushteve të Përgjithshme (Aneksi 3). Kërkesa për Pagesë duhet të dorëzohet në zyrën rajonale të SARED-it në adresën .

3.2 Pagesat duhet të bëhen në përputhje me Nenin 8 të Kushteve të Përgjithshme (Aneksi 3).

Në asnjë rast, shuma nuk mund të jetë më e lartë sesa ajo e deklaruar në paragrafin 1.1, as në drejtim të shumës absolute e as në drejtim të përqindjes.

3.3 Pagesa nga GIZ-ja duhet të bëhet në llogarinë e Përfituesit:

Mbajtësi i llogarisë:

Emri dhe vendi i bankës:

Numri i llogarisë:

Monedha e llogarisë:

Kodi Bankar:

Kodi Swift:

IBAN:

3.4 Përfituesi i Grantit

- a) Do të financojë paraprakisht shumën totale të Investimit;
Do të mbajë për pesë vjet pas dorëzimit të librave të gjendjes financiare përfundimtare, regjistrimet dhe kopjet origjinale të dokumentacionit mbështetës;
- b) Do të mundësojë për përfaqësuesit e GIZ-së dhe/ose auditorë të jashtëm të autorizuar nga GIZ-ja që deri në 5 vjet pas pagesës së balancës të konsultojnë këtë dokumentacion dhe çdo të dhënë apo dokument tjetër që lidhet me implementimin e Investimit dhe të vizitojnë të gjitha instalimet që lidhen me të;
- c) Do të japë çdo informacion për Investimin dhe progresin e saj të mëtejshëm, që mund të kërkojë GIZ-ja;
- d) Do të informojë menjëherë me iniciativën e tij GIZ-në për të gjitha rrethanat që seriozisht prekin ose vënë në rrezik arritjen e synimit të kësaj Marrëveshjeje ose zbatimin e Investimit;
- e) Nuk do të përdorë grantin për shpenzime tërësisht të financuara nga subvencione të tjera.

Neni 4

4.1 Përfituesi i Grantit, me lidhjen e kontratave për materialet dhe shërbimet që do të financohen nga granti, duhet të garantojë se procedurat janë në përputhje si pershkruhen ne Udhezuesin për Aplikantët dhe shpenzimet e pranueshme janë si më poshtë:

Shpenzime të pranueshme janë kosto që realisht kryhen nga Përfituesi i Grantit, që përmbushin kriteret e mëposhtme:

- a) Ato janë kryer dhe paguar gjatë periudhës së zbatimit të Investimit siç specifikohet në Nenin 1.3 të Marrëveshjes së Grantit (me përjashtim të kostove të përgjithshme siç përcaktohen në Udhezuesin e Aplikantëve). Investimi nuk mund të fillojë dhe Kontratat nuk mund të lidhen nga Përfituesit e Grantit përpara fillimit të periudhës së zbatimit të Investimit;
- b) Duhet të përfshihen në Tabelën e Shpenzimeve të Perlllogaritura të Investimeve (Aneksi 1) të kësaj kontrate;
- c) Duhet të jenë të nevojshme për zbatimin e Investimit;
- d) Janë të identifikueshme dhe të verifikueshme, në veçanti të regjistruara në regjistrat e kontabilitetit të Përfituesit të Grantit dhe të përcaktuara në përputhje me parimet e zbatueshme të kontabilitetit në Shqipëri dhe në përputhje me praktikat e zakonshme të llogaritjes së kostove të Përfituesit të Grantit;
- e) Janë të arsyeshme, të përligjura dhe në pajtim me kriteret e shëndosha financiare, në veçanti në lidhje me ekonominë dhe efijencën.

4.2 Përfituesi i Grantit duhet të bëjë të gjitha pagesat tek furnizuesit respektivë me transferta bankare (siç përshkruhet në Udhezuesin e Aplikantëve).

Neni 5

Pezullimi i Pagesave dhe Ripagesave

- 5.1 GIZ-ja do të ketë të drejtën ose të pezullojë ose të mbarojë pagesën sipas kërkesës për pagesë nëse:
- a) mallrat e blerë nga Përfituesi i Grantit për Investimin dhe për t'u financuar nga granti nuk përdoren ose pushojnë së përdoruri për qëllime të Marrëveshjes;
 - b) Përfituesi i Grantit ka shkelur ndonjë detyrim të kësaj Marrëveshjeje;
 - c) Përpara lidhjes së Marrëveshjes ose gjatë zbatimit të saj, Përfituesi i Grantit ka dhënë informacion të rremë ose nuk ka dhënë informacion që ndikon alokimin ose pagesën e grantit;
 - d) ka lindur ndonjë rrethanë e jashtëzakonshme që pengon ose vendos në rrezik serioz qëllimin e grantit, implementimin e Investimit, ose përmbushjen e detyrimeve të ndërmarra nga Përfituesi i Grantit në zbatim të kësaj Marrëveshjeje;

e) Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Mbretëria e Danimarkës mbaron, pezullon, ndryshon kontratën përkatëse me GIZ-në, që është baza e kësaj Marrëveshjeje.

5.2 GIZ-ja do të ketë të drejtë të kërkojë kthimin e menjëhershëm të të gjithë ose një pjese të grantit nëse lind ndonjë prej rrethanave të përmendura në Nenin 5.1 nga pika a) deri në pikën d) dhe nuk është ndrequr brenda një periudhe që përcaktohet nga GIZ-ja, e cila megjithatë nuk do të jetë më pak se 30 ditë. Aty ku zbatohet Neni 5.1.a), do të ripaguhet vetëm ato shuma që lidhen me mallrat përkatëse.

5.3 GIZ-ja do të ketë të drejtë të kërkojë kthimin e menjëhershëm të të gjithë grantit nëse Përfituesi i Grantit nuk e përdor grantin siç parashikohet në këtë Marrëveshje; aty ku Përfituesi i Grantit tjetëron, jep ose merr me qira asetet e financuara nga granti; aty ku Përfituesi i Grantit ndryshon qëllimin ose vendndodhjen e Investimit ose të aseteve të financuara nga granti; aty ku Përfituesi i Grantit nuk mban qëndrueshmërinë e Investimit për një periudhë prej 5 vjetësh pas pagesës së fundit të bërë në llogarinë e tij;

5.4 Përfituesi i Grantit merr përsipër të ripaguajë shumat që tejkalojnë shumën finale që i detyrohet GIZ-së brenda 15 ditëve të punës që nga lëshimi i dëftesës së debisë, kjo e fundit është letra me anë të të cilës GIZ-ja kërkon shumën që i detyrohet Përfituesi i Grantit. Për evitimin e dyshimeve, Neni 5.4 zbatohet gjithashtu edhe në rastet e mbipagesave për shkak të një gabimi administrativ të GIZ-së.

Neni 6

Dispozitat Përfundimtare

6.1 Përfituesi i Grantit duhet të garantojë se personat, të cilëve u ka besuar përgatitjen dhe zbatimin e Investimit dhe dhënia e kontratave për furnizimin e materialeve dhe shërbimeve që do të financohen, nuk kërkojnë, pranojnë, sigurojnë, japin, premtojnë ose pranojnë premtime për pagesa të paligjshme ose ndonjë avantazh tjetër në lidhje me këto detyra.

6.2 Në rast se një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, ajo nuk duhet të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të tjera. Çdo mangësi si pasojë e saj duhet të ndreqet nga një dispozitë në përputhje me qëllimin dhe synimin e kësaj Marrëveshjeje.

- 6.3 Përfituesi i Grantit nuk duhet të japë ose transferojë, lerë peng ose hipotekojë asnjë të drejtë të kësaj Marrëveshjeje.
- 6.4 Kjo Marrëveshje do të rregullohet nga legjislacioni Gjerman.
- 6.5 Vendi i kryerjes së pagesave do të jetë Tirana.
- 6.6 Vendi i juridiksionit do të jetë Frankfurt am Main.

Megjithatë, palët në këtë marrëveshje mund të dorëzojnë kërkesë padine në gjykatën e Tiranës/Shqipërisë.

- 6.7 Amendamentet dhe ndryshimet në këtë Marrëveshje si dhe deklaratat dhe njoftimet, që do të bëhen në përputhje me të, do të jenë të vlefshme vetëm me shkrim. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm gjatë periudhës së zbatimit siç përmendet në Nenin 1.3. Nëse nga Përfituesi i Grantit kërkohet një amendament, ai duhet ta dorëzojë kërkesën tek GIZ-ja tridhjetë (30) ditë pune përpara datës në të cilën duhet të hyjë në fuqi amendamenti, përveçse kur ekzistojnë rrethana të posaçme të vërtetuara siç duhet nga Përfituesi i Grantit dhe të pranuar nga GIZ-ja. Ndryshimet e adresës ose të llogarisë bankare mund të dërgohen me njoftim të thjeshtë, megjithëse kjo nuk e ndalon Autoritetin Kontraktor të kundërshtojë zgjedhjen e llogarisë bankare të Përfituesit të Grantit. Kërkesa(t) për amendamente do të merren në shqyrtim nga GIZ-ja dhe në rast të një miratimi do të nënshkruhet ndryshimi i marrëveshjes nga të dy palët duke përkrahur kushtet e reja të rena dakord.

Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën Shqipe dhe Angleze në dy kopje origjinale secila: një kopje origjinale për GIZ-në dhe një kopje origjinale për Përfituesin e Grantit. Në rast të ndonjë keqkuptimi do të mbizotërojë versioni në gjuhën Angleze.

Per GIZ

Perfituesi i Grantit

Tirane, _____

Tirane, _____

.....

.....

Drejtor i Përgjithshëm

Tirane, _____

.....

Menaxher i Projektit

Anekse:

Aneksi 1: Tabela e Shpenzimeve të Perlllogaritura

Aneksi 2: Përshkrimi i Investimit

Aneksi 3: Kushtet e Përgjithshme të zbatueshme për Marrëveshjen e Grantit

Aneksi 4 : Oferta/t nga furnizues(it) e përzgjedhur me specifikimet teknike

Fakultative:

Shtojca 5: "Fleta me Informacion për Punimet e Ndërtimit"(nuk është e nevojshme për projektet pa Punime Ndërtimi)